FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.30 5 prill 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 143, datë 18.1.2012	Për miratimin e listës paraprake (pjesa e parë + pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Tiranë, të qarkut të Tiranës……	1411
Vendim i KM nr. 146, datë 29.2.2012	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit, për bashkëpunim kulturor……	1412
Vendim i KM nr. 147, datë 29.2.2012	Për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Katarit, për bashkëpunim në fushën e turizmit……	1414
Vendim i KM nr. 149, datë 29.2.2012	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave për punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare……	1416
Vendim i KM nr. 150, datë 29.2.2012	Për transferimin e pasurisë nr. 20/81, truall, në zonën kadastrale nr. 8502, në pronësi të bashkisë së Beratit……	1419
Vendim i KM nr. 151, datë 29.2.2012	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjave kryesore të dërgimit të sistemeve të kanalizimeve të ujërave të zeza të Lezhës dhe Shëngjinit për në ITUP-in e qytetit të Lezhës……	1422
Vendim i KM nr. 154, datë 29.2.2012	Për miratimin e marrëveshjes tip për fillimin e procedurave për shuarjen, me kompensim, të detyrimeve të ndërsjella ndërmjet institucioneve buxhetore dhe jobuxhetore, ndërmarrjeve dhe shoqërive të kontrolluara nga shteti dhe "CEZ shpërndarje" sh.a……	1423

Vendim i KM nr. 156, datë 29.2.2012	Për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për 7 bashki dhe 10 komuna……	1427
Vendim i KM nr. 163, datë 29.2.2012	Për revokimin e vendimit nr. 264, datë 14.6.1997 të Këshillit të Ministrave "Për ruajtjen dhe sigurimin e uzinave ushtarake të rëndësisë së veçantë"……	1428
Vendim i KM nr. 164, datë 29.2.2012	Për një shtesë në vendimin nr. 585, datë 24.8.2011 të Këshillit të Ministrave "Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me përfaqësues në Ekipin Operacional të Patronazhit dhe Koordinimit Policor (POMLT), të vendeve të Kartës së Adriatikut, në operacionin ushtarak "ISAF", Afganistan"……	1428
Vendim i KM nr. 166, datë 9.3.2012	Për përfundimin e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësitë natyrore) në njësitë e qeverisjes vendore në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë dhe në rrethin e Librazhdit……	1429
Vendim i KM nr. 171, datë 6.3.2012	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin nr. 532, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave "Për pjesëmarrje të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacione ushtarake, në shtabe të ndryshme në Afganistan"……	1429
Vendim i KM nr. 172, datë 6.3.2012	Për disa shtesa në vendimin nr. 197, datë 16.3.2011 të Këshillit të Ministrave "Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak ndërkombëtar KFOR, Kosovë"……	1430
Vendim i KM nr. 173, datë 6.3.2012	Për emërim në detyrë……	1430
Vendim i KM nr. 174, datë 6.3.2012	Për emërim në detyrë……	1431
Vendim i KM nr. 175, datë 6.3.2012	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Lushnjë, të qarkut të Fierit….	1431
Vendim i KM nr. 176, datë 6.3.2012	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Shushicë, të qarkut të Elbasanit…….	1433
Vendim i KM nr. 179, datë 12.3.2012	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës……	1434

VENDIM
Nr. 143, datë 18.1.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE (PJESA E PARË + PJESA E DYTË) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË TIRANË, TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake (pjesa e parë+pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Tiranë, të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Tiranë, të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr. 834, datë 13.12.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së pjesshme të inventarit (pjesa e parë+pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Tiranë të qarkut të Tiranës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Tiranë — Lidhja nr.1

Numri rendor i pronës në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
132-135 (pjesa e parë) 2901,2910 (pjesa e dytë)	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi
280-391,393,395-408,434,435 (pjesa e parë) 2912-2917 (pjesa e dytë)	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
177-192,194-258,264-274,277-279,954 (pjesa e parë) 2911 (pjesa e dytë)	Prona që përdoren për realizimin e programeve sociale, kulturore, sportive	Në pronësi
850-863,866-897,899-920,921-939 (pjesa e parë)	Prona me interes vendor	Në pronësi
977-982,984-987,989-992,994,995 (pjesa e parë)	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
436-469 (pjesa e parë)	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
2796-2862,2864-3341 (pjesa e parë) 1-262 (pjesa e dytë)	Strehim dhe mbrojtje civile	Në pronësi
491-494,495-618,620-647,997 (pjesa e parë)	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve	Në pronësi
998-2433,2435-2723 (pjesa e parë) 263-2900 (pjesa e dytë)	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe, trotuar)	Në pronësi

VENDIM
Nr. 146, datë 29.2.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT, PËR BASHKËPUNIM KULTUROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Katarit, për bashkëpunim kulturor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
MBI BASHKËPUNIMIN KULTUROR NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe qeveria e Shtetit të Katarit, e përfaqësuar nga Ministria e Kulturës, Arteve dhe Trashëgimisë, në vijim të referuara si "Palët",

me dëshirën për të promovuar dhe zhvilluar bashkëpunimin reciprok midis dy vendeve në mënyrë miqësore, në fushën e kulturës, publikimeve dhe fushave të tjera të ngjashme,

bien dakord sa më poshtë:

Neni 1

Palët do të promovojnë dhe lehtësojnë bashkëpunimin kulturor midis dy vendeve të tyre nëpërmjet organizimit të javëve kulturore dhe ekspozitave të artit plastik ashtu si dhe shkëmbime të vizitave të grupeve muzikore, teatrore dhe artistike.

Neni 2

Palët do të shkëmbejnë informacion kulturor, foto dhe bookleta. Palët do të promovojnë gjithashtu bashkëpunimin midis bibliotekave kombëtare të të dyja vendeve. Për më tepër, Palët do të nxisin pjesëmarrjen e bibliotekave të tyre kombëtare dhe organizatave të lidhura me panairet e librit që do të mbahen në të dyja vendet.

Neni 3

Palët do të nxisin përkthimin e veprave të reja me çështje kulturore, artistike dhe letrare që mund të përçojnë kulturën e tyre në secilën gjuhë duke marrë në konsideratë të drejtat e autorit dhe rregullat e të shkruarit sipas marrëveshjeve dhe ligjeve ndërkombëtare.

Neni 4

Të dyja palët do të mbështesin përpjekjet për bashkëpunim reciprok midis qendrave dhe institucioneve të ndryshme rinore në të dyja vendet si më poshtë:

- shkëmbimin e informacionit, kërkimeve dhe studimeve që lidhen me punën për rininë;
- shkëmbimin e ftesave për të marrë pjesë në evenimente ndërkombëtare rinore të organizuara në secilin vend;
- shkëmbimin e vizitave të të rinjve në të dyja vendet për të vendosur bashkëpunimin, mirëkuptimin dhe për të realizuar rritjen e njohurive.

Neni 5

Palët do të krijojnë një komitet të përbashkët për të zbatuar nenet e kësaj marrëveshjeje, duke ekzaminuar ndonjë çështje që mund të dalë gjatë implementimit, ashtu si dhe të përfundohen programet periodike bilaterale të bashkëpunimit kulturor.

Neni 6

Pala dërguese do të mbulojë shpenzimet e udhëtimit për delegacionin e saj. Pala pritëse do të mbulojë shpenzimet e akomodimit, transportin lokal, rastet e kurimit mjekësor, emergjent, mbi bazën e rregullave në fuqi për këtë çështje.

Neni 7

Çdo mosmarrëveshje që lind midis palëve për interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet miqësisht përmes konsultimeve dhe bashkëpunimit midis tyre.

Neni 8

Dispozitat e kësaj marrëveshjeje apo pjesë të tekstit të saj mund të amendohen pas një miratimi me shkrim të të dyja palëve duke marrë parasysh procedurat ligjore të miratuara në të dyja vendet.

Neni 9

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën që palët do të njoftojnë njëra-tjetrën për plotësimin e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi dhe do të mbetet e vlefshme për një periudhë prej tre vjetësh, e rinovueshme në mënyrë automatike për periudhë/periudha të njëjta kohore, përveç kur njëra prej palëve i jep fund përmes një njoftimi me shkrim, të paktën tre (3) muaj para përfundimit ose datës së mbarimit të saj, nëpërmjet rrugëve diplomatike.

Përfundimi i kësaj marrëveshjeje nuk do të prekë asnjë program apo aktivitet ekzistues apo në vazhdim, përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe.

Në prani të dëshmitarëve, me anë të kësaj, të dy përfaqësuesit e autorizuar të qeverive palë nënshkruajnë këtë marrëveshje me autorizim të qeverive të tyre.

Bërë dhe nënshkruar në Tiranë më 18 tetor 2011, në dy kopje origjinale, duke qenë njëlloj autentike në gjuhët shqip, arabisht dhe anglisht. Në rast mospërputhjeje në interpretim, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.

VENDIM
Nr. 147, datë 29.2.2012

PËR MIRATIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT, PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E TURIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shtetit të Katarit, për bashkëpunim në fushën e turizmit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
MBI BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN E TURIZMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KATARIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Shtetit të Katarit (këtej e tutje të referuara si "palë kontraktuese"),

me dëshirën për të forcuar lidhjet midis dy vendeve dhe për të mbështetur dhe zhvilluar mënyrat e bashkëpunimit në fushën e turizmit, bazuar në shkëmbimet me interes të përbashkët për shtetet e tyre përkatëse,

duke kuptuar që turizmi është një shtyllë e ekonomisë dhe një nga mjetet e forcimit të mirëkuptimit midis dy shteteve,

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1
Përgatitjet për atmosferën bashkëpunuese

Palët kontraktuese do të krijojnë kushte të favorshme për bashkëpunim afatgjatë në fushën e turizmit për përfitime të përbashkëta të të dyja vendeve.

Neni 2
Fushat e bashkëpunimit

Palët kontraktuese, në fushat e planifikimit dhe zhvillimit të turizmit, në përputhje me ligjin, rregulloret, rregullat, procedurat dhe politikat e përcaktuara mbizotëruese në vendet e tyre përkatëse, do të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

A. Planifikimi dhe zhvillimi

Palët kontraktuese do të shkëmbejnë ekspertizë në njohjen e legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e turizmit dhe të procedurave specifike që lidhen me ushtrimin e aktiviteteve turistike, sikurse në përgatitjen e strategjive në fushën e turizmit.

B. Marketingu dhe promocioni

Palët kontraktuese do të bashkëpunojnë në këtë fushë nëpërmjet shkëmbimit të programeve, materialeve të propagandës dhe reklamës, botimeve, filmave, promocionit e marketingut të produkteve të turizmit të tyre nëpërmjet përfaqësuesve të mediave të udhëtimeve dhe eksperteve të specializuar në turizëm për të shkëmbyer ture midis dy vendeve.

C. Bashkëpunimi midis sektorëve privatë të turizmit

Palët kontraktuese do të mbështesin bashkëpunimin e fortë midis sektorëve të turizmit, operatorëve turistikë dhe agjentëve të udhëtimeve, si dhe firmave e zyrave të tjera të sektorit privat të turizmit në të dyja vendet.

D. Investimet në turizëm

Palët kontraktuese do të inkurajojnë sektorin publik e privat të investojnë në turizëm.

Rëndësi të veçantë do t'i kushtohet zhvillimit dhe implementimit të projekteve të turizmit që sjellin përfitime për palët kontraktuese.

Neni 3
Kostot financiare

Kostot financiare që rezultojnë nga implementimi i këtij memorandumi mirëkuptimi do t'i nënshtrohen legjislacionit vendas përkatës të secilës palë dhe do të jenë brenda kufijve të buxheteve që ato kanë në dispozicion.

Neni 4
Komitet i përbashkët

Palët kontraktuese do të ngrenë një komitet të përbashkët për të zbatuar masat që duhen për të plotësuar objektivat e synuara në këtë memorandum mirëkuptimi. Ku komitet do të mblidhet në takime sa herë që e kërkon nevoja. Për detajet do të bihet dakord nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 5
Koordinimi

Palët kontraktuese do të koordinojnë pozicionet e tyre në nivel ndërkombëtar, veçanërisht nëpër mbledhje, konferenca dhe forume të organizatave turistike të specializuara ndërkombëtare.

Neni 6
Marrëveshje të tjera

Ky Memorandum mirëkuptimi nuk do të ketë efekt në marrëveshje të tjera apo memorandume midis dy palëve, si dhe në ato që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi nga secila prej palëve kontraktuese me një palë të tretë.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje apo mospërputhje që mund të dalë nga implementimi i këtij memorandumi mirëkuptimi do të zgjidhet miqësisht nëpërmjet këshillimeve të drejtpërdrejta dhe dialogut midis palëve kontraktuese; në rast se kjo nuk do të jetë e mundur, zgjidhja do të bëhet nëpërmjet mjeteve diplomatike.

Neni 8
Ndryshimi i memorandumit të mirëkuptimit

Ky memorandum mund të ndryshohet ndërsa është në fuqi duke shkëmbyer nota diplomatike me shkrim midis palëve kontraktuese. Një ndryshim i tillë hyn në fuqi në përputhje me të njëjtat procedura ligjore të miratuara në formimin e këtij memorandumi mirëkuptimi. Çdo ndryshim do të zbatohet pa cenuar të drejtat dhe detyrimet, që dalin ose përcaktohen në këtë memorandum mirëkuptimi para se të shtohej një ndryshim i tillë.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi që nga data e shkëmbimit të notave diplomatike, në të cilat palët kontraktuese informojnë njëra-tjetrën në përmbushjen e procedurave të tyre ligjore të brendshme, të cilat janë të nevojshme për hyrjen në fuqi të memorandumit, dhe do të jetë i vlefshëm për pesë (5) vjet e do të rinovohet automatikisht për të njëjtën periudhë kohe, përveç kur njëra nga palët njofton tjetrën me shkrim mbi synimin për ta përfunduar atë të paktën gjashtë (6) muaj para datës së skadimit të tij.

Në rast të përfundimit të gjitha detyrimet që dalin prej tij dhe që nuk janë përmbushur gjatë periudhës së vlefshmërisë, do të mbetet në fuqi deri në përfundim.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit të autorizuar sipas rregullave nga qeveritë përkatëse kanë nënshkruar këtë memorandum mirëkuptimi.

Bërë në Tiranë, në datën 18 tetor 2011, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, arabe dhe angleze, ku të dyja tekstet janë njëlloj autentike. Në rast mospërputhjesh në interpretim, teksti në anglisht do të ketë përparësi.

VENDIM
Nr. 149, datë 29.2.2012

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERITARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare jepen sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, ku jepen elementet përbërëse, si më poshtë vijon:

a) Kategoria ose klasa për çdo funksion, kolona 2 e lidhjes nr. 1. Vlera mujore e pagës për çdo kategori dhe klasë është sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Paga e grupit, kolona 3 e lidhjes nr. 1, e cila përfitohet vetëm për nëpunësit me arsim të lartë universitar në funksionet e përcaktuara në këtë lidhje. Vlera mujore e pagës së grupit është sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

c) Shtesa për vjetërsi në punë, kolona 4 e lidhjes nr. 1, jepet:

- në masën 2 për qind në muaj pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit për kategorinë e nëpunësve me arsim të lartë universitar;

- në masën 1 për qind në muaj pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën bazë për klasë për kategorinë e punonjësve me arsim të mesëm.

ç) Shtesa për natyrë të veçantë pune, kolona 5 e lidhjes nr. 1. Vlera mujore e saj jepet vetëm për funksionet e specifikuara në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2012, përballohen nga fondet e planifikuara për vitin 2012 për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.

3. Të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA E PAGËS SË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË SHËRBIMIT QEVERITAR

Funksioni	**Kategoria klasa**	**Paga e grupit (lekë)**	**Shtesa për vjetërsi (%)**	**Shtesa për kushte pune(lekë)**
1	2	3	4	5
Drejtues institucioni	I-b	1	2%	
Drejtor njësie	III-a	1	2%	
Juristë	III-a/1	1	2%	
Përgjegjës i Pallatit të Kongreseve/Brigadave/Qendre	III-a/1	1	2%	
Specialist i Burimeve Njerëzore dhe sek. e Bordit Drejtues	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	7000
Specialist i Shërbimit Mercolog/administrimi/financës Durrës	IV-a	1 ose 2 ose 3	2%	
Sekretare	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	
Specialist/inspektor njësie	IV-b	1 ose 2 ose 3	2%	
Përgjegjës i Qendrës së Shërbimit në Institucione	X		1%	17450
Përgjegjës VIP Rinas	X		1%	2000
K/kuzhinier i K/Ministrit dhe aktiviteteve kryesore	X		1%	43500
Përgjegjës i brigadës teknike/vilës 30, 31, vilës Dajt, vilës Velipojë	X		1%	7300
Përgjegjës protokoll/arshive	X		1%	
Magazinier i magazinësqendrore/përgjegjësbrigade gjelbërim	IX		1%	
Përgjegjës i brigadës së gjelbërimit	IX		1%	
Banakierë/kamerierë në Presidencë/Kuvend/KM/Kryeministrit	IX		1%	
Punonjës shërbimi në rezidencë tek Presidenti/Kryetari i	IX		1%	

Parlamentit/Kryeministrit/kryepunonjës në rezidencë, vila 4				
K/pastiçierë	IX		1%	8000
Magazinierë/(magazinë dytësore)	VIII		1%	
Teknik (Pallati i Brigadave, vila Dajt, vila nr. 1 Vlorë, vila 31) teknik në sektorin e shërbimit teknik	VIII		1%	
Banakierë/kamerierë në salla Parlament/Pallati i Kongreseve, VIP Rinas/vila 31	VIII		1%	
Kuzhinier, vila 4 Rezidenca e Presidentit	VIII		1%	17800
Kuzhinier, vila 30/kryekamerier, vila 31	VIII		1%	12700
Ndihmëskuzhinier, vila 31	VIII		1%	
Pastiçierë, vila 31	VIII		1%	6000
Banakierë dhe përgjegjës material vila 31	VIII		1%	4600
Kuzhinier rezidencat Vlorë	VIII		1%	
Punonjës Qendra Durrës në rezidencën e Presidentit, Kryetarit të Parlamentit, Kryeministrit dhe në rezidencën nr. 23	VIII		1%	
Shofer, teknik dispeçer, ndihmësteknik/muratori i sektorit të shërbimit teknik, teknik mirëmbajtjeje në Pogradec, Sarandë, Velipojë, Durrës, Pallati i Kongreseve, Qendra e Transportit	VII		1%	
Furnitor	VII		1%	9000
Banakiere Gjykata Kushtetuese, punëtorë pastrimi dhe kamerierë v	VII		1%	
Punëtorë rezidence vila Dajt	VII		1%	
Punëtorë pastrimi dhe kamerier Pogradec	VII		1%	
Punëtorë dhe përgjegjëse materiali, vila 29 dhe 18 Durrës	VII		1%	
Punëtorë, magazine, lavanterie, gjelbërimi, pastrimi, rojë, rojë bahçevan, punëtor mirëmbajtjeje, ndërtimi	V		1%	

Lidhja nr.2

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR DIPLOMAT E ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	**Lloji i diplomës**	**Vlera**
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND) Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND) Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	13 000 lekë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)	11 000 lekë
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP). Të barasvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë	10 000 lekë

Lidhja nr.3

VLERA E PAGËS PËR ÇDO KATEGORI/KLASË

lekë/muaj

Kategoria/klasa	**Vlera për kategori/klasë**
I-b	117.300
III-a	72.500
III-a/1	63.300
IV-a	43.900
IV-b	33.700
X	37000
IX	35000
VIII	31500
VII	28500
V	24600

VENDIM
Nr. 150, datë 29.2.2012

PËR TRANSFERIMIN E PASURISË NR. 20/81, TRUALL, NË ZONËN KADASTRALE NR. 8502, NË PRONËSI TË BASHKISË SË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 8 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të bashkisë së Beratit të pasurisë nr. 20/81, truall, në zonën kadastrale nr. 8502, me sipërfaqe 7663 (shtatë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre) m^2, pjesë e pronës nr. 1317, në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë e Beratit, sipas formularit dhe planvendosjes bashkëlidhur, për ngritjen e tregut industrial.

2. Bashkisë së Beratit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i bashkisë Berat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Bashkia: Berat

Kartela e pasurisë me nr. 20/81

	A			B			C			
Nr. rendor	**Zona kadast.& indeksi i hartës**	**Nr. pasurisë**	**Lloji i pasurisë**	**Emir i pronës adresa**	**Sipërfaqe totale e pronës (m^2)**	**Nga sipërfaqa totale, sa ndërtesë (m^2)**	**Funksioni për të cilin përdoret prona**	**Institucioni/enti me përgjegjësi administrative**	**Institucioni/enti përdorues statusi juridik i përdorimit**	**Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)**
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**	**10**	**11**
1317	8502 M-7	20/81	Truall	Ish fushë sporti (truall) lagjja 30 vjetori bashkia Berat	7663	-	Sport	Bashkia Berat	Bashkia Berat	Sipërfaqja totale 10 831 m^2; nga kjo kalon për tregun sipërfaqja 7663 m^2; pjesa tjetër është ngushtuar nga qytetarët me ndërtime pa leje.

Shënim. Në kllapa janë shënuar korrigjimet e nevojshme.

GENT PLANI

Pergatiti
Ing. Sllavi Dhrami
Liç, nr. K 0114/2

Data e Pregatitjes 01.11.2011

vula / Firma

IDENTIFIKIMI I PASURISE:
ZONA KADASTRALE 8502
NR.PASURISE: 20/81
INDEKSI I HARTES: BR; M - 7
SHKALLA 1 : 1 000
ADRESA E PASURISE: QARKU BERAT RRETHI BERAT
QYTETI BERAT ; L. 30 VJETORI

PRONARI: **BASHKIA BERAT**
emer atesi mbiemri




horografia e tregut

VENDIM
Nr. 151, datë 29.2.2012

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJAVE KRYESORE TË DËRGIMIT TË SISTEMEVE TË KANALIZIMEVE TË UJËRAVE TË ZEZA TË LEZHËS DHE SHËNGJINIT PËR NË ITUP-IN E QYTETIT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjave kryesore të dërgimit të sistemeve të kanalizimeve të ujërave të zeza të Lezhës dhe Shëngjinit për në ITUP-in e qytetit të Lezhës.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 1 680 (një mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) m^2, vlerësuar me çmimet e AKKP-së, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 719 040 (shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyzet) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 340 000 (treqind e dyzet mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 719 040 (shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e dyzet) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2012, zëri "Kosto lokale", miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve.

6. Shpronësimi të fillojë nga data 1.3.2012.

7. Pronarët e pasurive të ndodhura në zonën kadastrale nr. 8270, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë të rifreskuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës - Kanalizimeve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve të kryejë likuidimet për efekt shpronësimi për pronarët sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të rifreskuar që do të dorëzojnë pronarët.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Lezhë, në bashkëpunim me Ujësjellës-Kanalizime, sh.a., Lezhë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së shpronësimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Ujësjellës-Kanalizime, sh.a., Lezhë.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Lezhë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së shpronësimit në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, Ujësjellës-Kanalizime, sh.a., Lezhë, Zyra

Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Lezhë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT "NDËRTIMI I LINJAVE KRYESORE TË DËRGIMIT TË SISTEMEVE TË KUZ-ve TË LEZHËS DHE SHËNGJINIT PËR NË ITUP-in E QYTETIT TË LEZHËS"

Nr.	Pronari			ZK	Nr. pas.		Tokë, arë		Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m^2	Çmimi	Vlera lekë	
	Fshati Ishull-Shëngjin, komuna Shëngjin Z.K.1987								
1	Paulin	Ndue	Gjergji	1987	14/7	450	428	192600	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Kol	Tom	Cali	1987	109/1	450	428	192600	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Pëllumb		Vuksani	1987	60/94	200	428	85600	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Ndue		Pervata	1987	60/35	160	428	68480	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Ndue	Zef	Ndoja	1987	60/177	210	428	89880	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Gëzim	Nikoll	Pali	1987	60/138	210	428	89880	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
		Totali				**1680**		**719040**	

VENDIM
Nr. 154, datë 29.2.2012

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES TIP PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHUARJEN, ME KOMPENSIM, TË DETYRIMEVE TË NDËRSJELLA NDËRMJET INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE JOBUXHETORE, NDËRMARRJEVE DHE SHOQËRIVE TË KONTROLLUARA NGA SHTETI DHE CEZ SHPËRNDARJE SHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetues, të nenit 7 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", të ndryshuar, dhe të nenit 514 e në vijim, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Ministrit të Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Ministrit të Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes për fillimin e procedurave për shuarjen, me kompensim, të detyrimeve të ndërsjella ndërmjet institucioneve buxhetore dhe jobuxhetore, ndërmarrjeve dhe shoqërive të kontrolluara nga shteti dhe "CEZ Shpërndarje", sh.a., sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Financave autorizohet të përdorë të gjitha procedurat shtrënguese ligjore, me qëllim që të shlyhen në një kohë sa më të shkurtër detyrimet e institucioneve buxhetore dhe

jobuxhetore të marra përsipër nga KESH-i dhe OST-ja, sipas kësaj marrëveshje, si dhe të gjitha detyrimet e tjera që nuk janë pjesë e kësaj marrëveshjeje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHUARJEN ME KOMPENSIM TË DETYRIMEVE TË NDËRSJELLA MIDIS INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE JOBUXHETORE, NDËRMARRJEVE DHE SHOQËRIVE TË KONTROLLUARA NGA SHTETI DHE CEZ SHPËRNDARJE SHA

Sot më datë 28 shkurt 2012 lidhet kjo marrëveshje midis;

- Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës përfaqësuar nga z. Nasip Naço, Ministër; Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, përfaqësuar nga z. Spiro Ksera, Ministër; Ministrisë së Shëndetësisë, përfaqësuar nga z. Petri Vasli, Ministër; Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësuar nga z. Eduard Halimi, Ministër; Ministrisë së Punëve Publike dhe Transporteve, përfaqësuar nga z. Sokol Olldashi, Ministër; Ministrisë së Financave, përfaqësuar nga z. Ridvan Bode, Ministër; KESH sh.a., përfaqësuar nga z. Engjëll Zeqo, Administrator; OST sh.a., përfaqësuar nga z. Arben Ibroja, Administrator dhe CEZ shpërndarje sh.a., përfaqësuar nga z. Martin Nemecek, anëtar i Bordit të Drejtorëve dhe Drejtor Menaxhues dhe z. Jan Ivan, anëtar i Bordit të Drejtorëve dhe Drejtor Financiar.

Duke marrë parasysh që:

a) Disa institucione buxhetore (në varësi të MPPÇSHS, MPPT, MSH dhe MD), si dhe institucionet jobuxhetore në formën e shoqërive aksionare të përfshira në këtë marrëveshje (në të cilat të drejtat e shtetit përfaqësohen nga METE), kanë detyrime financiare të paekzekutuara/palikuiduara ndaj shoqërisë "CEZ shpërndarje" sh.a., në formë detyrimesh të papaguara dhe/ose të paguara me vonesë, të faturave të energjisë elektrike (përfshirë edhe vlerat e kamatëvonesave për vonesë në ekzekutim, të përllogaritura në bazë të kushteve kontraktore dhe/ose parashikimeve ligjore);

b) "CEZ shpërndarje" sh.a., ka detyrime financiare të paekzekutuara/palikuiduara ndaj KESH sh.a., dhe OST sh.a., në formë faturash të papaguara (përfshirë edhe vlerat e kamatëvonesave për vonesë në ekzekutim, të përllogaritura në bazë të kushteve kontraktore dhe/ose parashikimeve ligjore);

c) Palët që nënshkruajnë këtë marrëveshje, kanë qëllim dhe bien dakord që të shuajnë me kompensim detyrimet e ndërsjella ndërmjet institucioneve dhe shoqërive tregtare të përmendura në këtë marrëveshje, pasi të jetë realizuar rakordimi i plotë i detyrimeve ndërmjet palëve të interesuara;

d) për të arritur qëllimin e shuarjes me kompensim të detyrimeve KESH sh.a., marrin përsipër të pranojnë dhe të zëvendësojnë institucionet buxhetore, jobuxhetore, të përcaktuara në këtë marrëveshje, në detyrimet e tyre ndaj "CEZ shpërndarje" sh.a., në bazë të parashikimeve të Kodit Civil (nenet 496 e në vazhdim të Kodit Civil), duke bërë të mundur shuarjen me kompensim të detyrimeve reciproke sikurse parashikohet në Kodin Civil (nenet 514 e në vazhdim të Kodit Civil)

"CEZ shpërndarje" sh.a., pranon zëvendësimin e debitorëve dhe transferimin e detyrimeve tek KESH sh.a., dhe OST sh.a.,

palët bien dakord që:

1. Të shuhen me kompensim të gjitha detyrimet e lindura deri në datën 31.12.2011, të institucioneve sipas aneksit 1 bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje. Detyrimet që lindin pas kësaj date apo pagesat për detyrime që maturohen pas kësaj date, nuk janë pjesë e kësaj marrëveshjeje. Përfaqësuesit e institucioneve qendrore që janë palë në këtë marrëveshje, impenjohen që të monitorojnë institucionet e vartësisë për shlyerjen e detyrimeve ndaj "CEZ shpërndarje" sh.a., si dhe të bëjnë çdo përpjekje institucionale që të sigurojnë në të ardhmen pagesat e detyrimeve ndaj "CEZ shpërndarje" sh.a.

2. Afati përfundimtar për realizimin nga palët të aktrakordimeve dhe saktësimin e detyrimeve financiare të papaguara dhe ose të paguara me vonesë që rezultojnë deri më datë 31.12.2011, është fund i muajit prill 2012 ose një datë e rënë dakord midis MOF dhe "CEZ Shpërndarje". "CEZ shpërndarje" sh.a., brenda afatit dy javor të parashikuar në pikën 8 të kësaj marrëveshjeje, bie dakord t'i parapaguajë KESH sh.a. dhe OST sh.a., shumën totale prej 4 miliardë lekë. Kjo shumë përfaqëson pagimin e një pjese të detyrimit të "CEZ shpërndarje" ndaj KESH dhe OST.

3. Në zbatim të kësaj marrëveshje:

- "CEZ shpërndarje" sh.a., brenda datës 31 mars 2012, të paraqesë pranë ministrive përkatëse (përkatësisht MPÇSSHB, MPPT, MSH dhe MD, duke klasifikuar detyrimin sipas institucionit buxhetor) të gjitha aktrakordimet, vendimet për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit dhe/ose vendimet gjyqësore të formës së prerë, për detyrimet që rezultojnë deri më datë 31.12.2011 dhe të përditësuara deri në datën e nënshkrimit të marrëveshjes, për të gjitha institucionet buxhetore dhe jobuxhetore, ndërmarrjet shtetërore, shoqëritë publike, aksionet e të cilave zotërohen nga shteti, agjencitë dhe institucionet të cilat janë struktura të varësisë së tyre. "CEZ shpërndarje", në diskrecionin e vet, ka të drejtën të shtyjë me 2 muaj shtesë afatin e depozitimit të aktrakordimeve/vendimeve në rast vonesash për marrjen e këtyre dokumenteve nga institucionet e tjera sikurse mund të jenë institucionet debitore apo gjykatat. Palët e kësaj marrëveshjeje do të ndërmarrin të gjitha përpjekjet që të përshpejtojnë procesin e përgatitjes së aktrakordimeve.

- MPPT, MSH dhe MD brenda 15 ditëve nga marrja në dorëzim e informacioneve të mbërritura nga "CEZ shpërndarje" sh.a., aktrakordimet, vendimet gjyqësore, si dhe çdo informacion tjetër që justifikon detyrimin e papaguar ndaj "CEZ shpërndarje" sh.a., dorëzon pranë Ministrit të Financave konfromimin për saktësinë e detyrimeve.

- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, brenda 15 ditëve nga marrja në dorëzim e informacioneve të mbërritura nga "CEZ shpërndarje" sh.a., si dhe çdo informacion tjetër që justifikon pagesat e reduktuara të pranuara nga "CEZ shpërndarje" sh.a., në lidhje me kompensimin e energjisë elektrike të përfituara nga personat e paaftë (invalidët) në kuptim të dispozitave të ligjit nr. 8089, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit" (i ndryshuar), ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik" dhe parashikimeve të vendimit nr. 83, datë 26.2.2001 të Këshillit të Ministrave "Për tarifat telefonike dhe për pagesat elektrike nga personat me aftësi të kufizuar", të ndryshuar, dorëzon pranë Ministrit të Financave konfirmim për saktësinë e detyrimeve.

"CEZ shpërndarje" sh.a., KESH sh.a. dhe OST sh.a. marrin përsipër që brenda datës 31.3.2012 të rakordojnë detyrimet që ka ndaj tyre "CEZ shpërndarje" sh.a., deri më 31.12.2011 dhe t'i depozitojnë këto aktrakordime pranë Ministrisë së Financave.

4. Pas aktrakordimeve të bëra sipas pikës 3 të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Ekonomisë, KESH-sh.a., OST sh.a. dhe CEZ Shpërndarje sh.a., arrijnë një marrëveshje përfundimtare për shuarjen me kompensim të detyrimeve reciproke, brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të aktrakordimeve përkatëse.

5. Detyrimet deri në 31.12.2011, të cilat janë në proces gjyqësor, por për të cilat nuk ka një vendim gjyqësor të formës së prerë, nuk janë objekt i procesit të shuarjes me kompensim të detyrimeve, përveç rasteve kur palët përkatëse kanë rënë dakord ndryshe.

6. Detyrimet e pretenduara nga "CEZ shpërndarje" sh.a., të cilat mund të kenë lidhje me procesin e privatizimit, do të zgjidhen midis KESH sh.a., CEZ shpërndarje sh.a. dhe METE, jashtë kësaj marrëveshjeje dhe në respektim të procedurave ligjore përkatëse.

7. E gjithë vlera e kamatëvonesave që institucionet buxhetore, jobuxhetore dhe shoqërive tregtare shtetërore të listuara në aneksin 1, i detyrohen "CEZ shpërndarje" deri më 31.12.2011, do të shuhet me kompensim ndaj vlerës së kamatëvonesave që KESH dhe OST sh.a. pretendojnë ndaj "CEZ shpërndarje" sh.a. Në rast se ndonjëra nga palët ka faturuar pagesë për kamatëvonesa të maturuara deri më 31.12.2011, kjo palë do t'i lëshojë një faturë tjetër tatimore (*credit note*) palës tjetër për të njëjtën shumë. Palët janë në dijeni dhe pranojnë që diferenca në vlerë ndërmjet këtyre shumave të pretenduara apo efektivisht të faturuara nga palët do të quhet e shuar dhe palët do të heqin dorë nga çdo kërkesë apo pretendim për pagesë kamatash në lidhje me detyrimet e kompensuara sipas kësaj marrëveshjeje. Shuarja e pretendimeve për kamatvonesat dhe modalitetet teknike të kompensimit dhe shuarjes së pretendimeve do të rregullohet në marrëveshjen finale të kompensimit ndërmjet KESH, OST dhe CEZ.

8. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe bëhet efektive me pagesën nga "CEZ shpërndarje" sh.a. të shumës prej 4 miliardë lekë që përcaktohet në paragrafin 2 më sipër, pagesë e cila do të ndodhë jo më vonë se 2 (dy) javë pas miratimit nga Këshilli i Ministrave. Pas pagimit të kësaj shume, pezullohen të gjitha veprimet e KESH sh.a. dhe OST sh.a. për vënien në ekzekutim të detyrimeve, të cilat janë objekt i shuarjes me kompensim sipas kësaj marrëveshjeje. Nëse marrëveshja nuk bëhet efektive brenda dy javëve nga miratimi i saj në Këshillin e Ministrave ajo konsiderohet e pavlefshme dhe secila prej palëve në marrëveshje është e çliruar nga detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje. Në këtë rast, asnjëra prej palëve nuk do të pretendojë asnjë përgjegjësi dhe/ose kompensim dëmesh nga pala tjetër për veprime dhe/ose mosveprime lidhur me këtë kontratë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode
MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço
MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi
MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi
MINISTRI I SHËNDETËSISË
Petrit Vasili
MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera
KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SHA
Engjëll Zeqo
OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
Arben Ibroja
CEZ SHPËRNDARJE SHA
Martin Nemecek, Jan Ivan

VENDIM
Nr. 156, datë 29.2.2012

PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE, PËR 7 BASHKI DHE 10 KOMUNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, për 7 (shtatë) bashki dhe 10 (dhjetë) komuna, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Fondi, në vlerën 15 219 706 (pesëmbëdhjetë milionë e dyqind e nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtë) lekë, të përballohet nga Fondi i Kontingjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2012.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

Nr.	Emri i NJQV-së	Vlera (në lekë)
1	Bashkia Bajram Curri	473,125
2	Bashkia Patos	2,948,500
3	Bashkia Bilisht	1,079,750
4	Bashkia Çorovodë	1,097,500
5	Bashkia Poliçan	719,225
6	Bashkia Fushë-Krujë	1,419,250
7	Bashkia Sukth	605,500
8	Komuna Dermenas	436,250
9	Komuna Udenisht	233,250
10	Komuna Cukalat	45,750
11	Komuna Mollas (Ersekë)	43,722
12	Komuna Perondi	713,248
13	Komuna Poshnjë	281,845
14	Komuna Miras	218,875
15	Komuna Tërbuf	2,573,606
16	Komuna Lekaj	1,026,000
17	Komuna Otllak	1,304,310
	Shuma	**15,219,706**

VENDIM
Nr. 163, datë 29.2.2012

PËR REVOKIMIN E VENDIMIT NR. 264, DATË 14.6.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E UZINAVE USHTARAKE TË RËNDËSISË SË VEÇANTË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121, pika 1 e 124 pika 1 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Revokimin e vendimit nr. 264, datë 14.6.1997 të Këshillit të Ministrave "Për ruajtjen dhe sigurimin e uzinave ushtarake të rëndësisë së veçantë".

2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 164, datë 29.2.2012

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 585, DATË 24.8.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME PËRFAQËSUES NË EKIPIN OPERACIONAL TË PATRONAZHIT DHE KOORDINIMIT POLICOR (POMLT), TË VENDEVE TË KARTËS SË ADRIATIKUT, NË OPERACIONIN USHTARAK "ISAF", AFGANISTAN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11, të nenit 14, të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të Drejtimit Strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 4 të vendimit nr. 585, datë 24.8.2011 të Këshillit të Ministrave, pas fjalëve "… Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 muaj …" të shtohen fjalët "… së cilës i shtohet edhe periudha e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës …".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 166, datë 9.3.2012

PËR PËRFUNDIMIN E GJENDJES SË EMERGJENCËS CIVILE (FATKEQËSITË NATYRORE) NË NJËSITË E QEVERISJES VENDORE NË QARQET SHKODËR, KUKËS, DIBËR, KORÇË DHE NË RRETHIN E LIBRAZHDIT

Në mbështetje të nenit 100 e 174 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 2 shkronja "c" e 6 pika 3, të ligjit nr. 8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfundimin e gjendjes së emergjencës civile (fatkeqësitë natyrore), si rezultat i përmirësimit të kushteve natyrore të motit, në njësitë e qeverisjes vendore në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Korçë dhe në rrethin e Librazhdit.

2. Përfundimin e veprimtarisë së Komitetit Ndërministror të Emergjencave Civile.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 171, datë 6.3.2012

PËR NJË SHTESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 532, DATË 7.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PJESËMARRJE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONE USHTARAKE, NË SHTABE TË NDRYSHME NË AFGANISTAN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të Drejtimit Strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 532, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

a) Në pikat 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6, pas fjalëve "… me rotacion 6 (gjashtë) muaj …" shtohen fjalët "… së cilës i shtohet edhe periudha e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës …".

b) Në pikën 2, fjala "… mbivendosje …" zëvendësohet me fjalët "… shpenzime për zhvillimin e aktiviteteve social - kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit …".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 172, datë 6.3.2012

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 197, DATË 16.3.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK NDËRKOMBËTAR KFOR, KOSOVË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 197, datë 16.3.2011 të Këshillit të Ministrave, të bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Në pikën 3, pas fjalëve "… Kohëzgjatja e misionit është deri 2 (dy) vjet, me rotacion 6 (gjashtë) muaj …" shtohen fjalët "… së cilës i shtohet edhe periudha e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës …".

b) Pas shkronjës "f", të pikës 5, shtohet shkronja "g", me këtë përmbajtje:

"g) shpenzime për zhvillimin e aktiviteteve social - kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 173, datë 6.3.2012

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ardian Tano të emërohet Zëvendësministër i Arsimit dhe Shkencës.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 174, datë 6.3.2012

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 6 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Abaz Hado të emërohet Zëvendësministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 175, datë 6.3.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË LUSHNJË, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Lushnjë, të qarkut të Fierit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 270 (dyqind e shtatëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 4 270 (katër mijë e dyqind e shtatëdhjetë).

Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Lushnjë Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9, 11-24, 26-52	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
53-75	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
170-179	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
240,241,243-245	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
251-254	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën sociale	Në pronësi
255-360	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
361,3281-3295,3296-3880	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
362-367	Varreza publike	Në pronësi
440,446	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
448-3280	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
3930-3933,3936,3938-3942 3944-3950	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim DAMT e qarkut Fier dhe bashkia Lushnjë ka vënë në dispozicion nga kjo bashki sipërfaqen prej 158.58 ha tokë bujqësore në Saravë (pasuria nr.3939, në lidhjen nr.1 të projektvendimit të sipërcituar), sipërfaqen prej 5355 ha tokë bujqësore (pasuritë me nr. 3940 dhe 3941
3934,3935,3937,4051,4055,4057,4059,4061-4063,4065-4068,4073-4083,4085,4087-4102,4106,4112-4115,4117-4119,4122-4134,4136-4149,4152,4154,4157-4161,4165,4166,4187-4201,4203	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
368-415,3881-3912,3959-3962	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr. 176, datë 6.3.2012

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS SHUSHICË, TË QARKUT TË ELBASANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Shushicë, të qarkut të Elbasanit, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi. Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Shushicë, të qarkut të Elbasanit, miratuar me vendimin nr. 70, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Shushicë, të qarkut të Elbasanit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Shushicë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Shushicë — Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative	Në pronësi
2-13,1296,1297,1323,1334,1366,1368	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
14-22	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
23-54	Varrezat publike	Në pronësi
55-56	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
59,60,66-70,75,78-80,84,85,90-93	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
62,64,65,72,74,77,82,83,88,89,95, 102,112,1224,1225,1544-1567 (objekte bujqësie)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
462-1105,1392-1413,1510-1540	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
1108-1111	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
1339,1371-1373,1380-1383,1541-1543,1568-1639	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi

VENDIM
Nr. 179, datë 12.3.2012

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a" të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 17 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, zëri "Shpenzime korente", të bëhet rishpërndarja e fondeve në programet buxhetore, si më poshtë vijon:

a) Në programin "Arsimi profesional", 09240, pakësohet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh.

b) Në programin "Për kërkim fondamental dhe ekselencë", 09770, pakësohet fondi prej 46 700 000 (dyzet e gjashtë milionë e shtatëqind mijë) lekësh.

c) Në programin "Arsimi bazë", 09120, shtohet fondi prej 61 700 000 (gjashtëdhjetë e një milionë e shtatëqind mijë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 3.4.2012
Doli nga shtypi më 5.4.2012

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 32 lekë